



Pranuar / Dorëzuar Punëdhësi/Prudato Received/Delivered	28-02-2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jednica Org. Unit	Nr. Prot. Hr. Prot. Prot. No.	Shtypje Printog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRIBETEK	1037/2022		114



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.52/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.52/2022 të datës 24.01.2022, të parashtruar nga ankuesja me adresë banimi:

kundër organit të punësimit Këshilli i Sigurisë së Kosovës, në çështjen juridike "vlerësim i rezultateve në punë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren 02/2018, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.02.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa A.nr.52/2022 e datës 24.01.2022, e parashtruar nga ankuesja
- II. Ndryshohet Formulari i Vlerësimit të Rezultateve në Punë për vitin 2021, për ankuesen lidhur me periudhën e vlerësimit ashtu që periudha 01.01.2021 deri 10.11.2021 zëvendësohet më periudhën 30.03.2021 deri me 09.11.2021.
- III. Obligohet mbikëqyrësi pasues i ankueses që brenda afatit prej pesëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi, të bëjë vlerësimin e rezultateve të punës për ankuesen për periudhën nga data 10.11.2021 deri me 31.12.2021.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim lidhur zbatimin e këtij vendimi.

**A r s y e t i m**

Ankuesja nëpunëse civile në Këshillin e Sigurisë së Kosovës, me datë 24.01.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër

vlerësimin vjetor të punës për vitin 2021, të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Sigurisë së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 31.01.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Këshilli i Sigurisë së Kosovës. Ndërsa me datë 08.02.2022 Këshilli ka pranuar shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokoll 297/2022 të datës 24.01.2022 të parashtruar ë Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin për Vlerësimin e Rezultateve në punë për vitin 2021, për ankuesen [ ] të datës 20.01.2022; Vendimin me numër protokoll 99/2009 të datës 06.11.2009 të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Sigurisë se Kosovës; Vendimin me numër protokoll 253/2009 të datës 23.06.2009 të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Sigurisë se Kosovës; Vendimin me numër protokoll 33/2011 të datës 09.02.2011 të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Sigurisë se Kosovës; Vendimin me numër protokoll 066/2021 të datës 17.05.2021, të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Sigurisë së Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 08.02.2022; Akt Emërimit me numër protokoll 351/2011 të datës 30.12.2011; Përshkrimin e detyrave të punës; për ankuesen e-mailin e datës 17.01.2022, dërguar nga [ ] për [ ] e-mailin e datës 11.01.2022, dërguar nga [ ] për [ ]

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar me kujdes provat e lëndës, konstatoi se ankesa e ankueses [ ] është pjesërisht e bazuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesja sipas Akt emërimit me numër protokoll 351/2011 të datës 30.12.2011, është e punësuar në Këshillin e Sigurisë së Kosovës, në pozitën e punës "Asistente administrative" në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Sigurisë së Kosovës.

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Sigurisë së Kosovës në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankueses, me datë 20.01.2022 ka bërë Vlerësimin e rezultateve të punës për periudhën 01.01.2021 deri 10.11.2021, duke vlerësuar ankuesen me notë të përgjithshme 3.28.

Ankuesja brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore se në vlerësim është përfshirë periudha gjatë të cilës ankuesja ka qenë në pushim të lehonisë, tutje shton se nuk është e kënaqur me vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021, pasi e njëjta ka përmbushur me kohë dhe me rezultate të mira detyrat dhe punët që më janë dhënë.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve të ngritura në ankesë, Kolegji ka analizuar nenin 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë, më të cilin përcaktohet se: 1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i përhershëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuar dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit civil në realizimin e objektivave. Periudha e vlerësimit zgjat 1 vit dhe fillon nga 1 janari dhe mbaron më 31 dhjetor. Vlerësimi bëhet deri më 31 janar të vitit të ardhshëm, për vitin pasues. 2. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në objektivat e përcaktuar në mënyrë individuale për nëpunësin që vlerësohet, në përputhje me përshkrimin përkatës të punës dhe objektivat e njësisë apo institucionit..... 5. Nëpunësi civil vlerësohet nga mbikëqyrësi i tij i drejtpërdrejtë. Në rastin e ndërrimit të mbikëqyrësit përpara përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse. ....

si dhe nenin 5 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike ku përcaktohet se:... 2. Nëse gjatë periudhës së vlerësimit, ndërrohet mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i nëpunësit para përfundimit të vlerësimit vjetor, ai vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse, ndërsa për periudhën e mbetur të vlerësimit vjetor, vlerësimi bëhet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt pasues, rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka konstatuar se me Vendimin me numër protokolli 163/2020 të datës 06.07.2020, të U.d Sekretarit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës, ankuesja ka qenë në pushim të lehonisë nga data 29.06.2020 deri me 29.03.2021, ndërsa sipas Vendimit me numër protokolli 11/14 të datës 10.11.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, mbikëqyrësit të ankueses i është ndërprerë marrëdhënia e punës në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Sigurisë së Kosovës, Andaj, mbi këto arsye, rrjedhë se vlerësimi i rezultateve të punës së ankueses duhet të përfshinte vetëm periudhën nga data 30.03.2021 deri me 09.11.2021, ndërsa për periudhën nga data 10.11.2021 deri me 31.12.2021, vlerësimi duhet të bëhet nga mbikëqyrësi pasues gjegjësisht zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshme të Këshillit të Sigurisë së Kosovës, kështu që në këtë kuptim është i bazuar pretendimi ankimor i ankesës.

Sa i për këtë pretendimit ankimor lidhur me notat e vlerësimit, Kolegji duke u bazuar në nenin 11 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, konstatoi se ankuesja ka notë të përgjithshme vlerësimi 3.28, e që në kuptim të dispozitave si me lartë ky vlerësim përcaktohet "mirë" dhe nënkupton se ankuesja ka realizuar të gjitha objektivat e punës, dhe ka treguar aftësi të pritshme të punës, e mbi këto arsye rezulton se është i pabazuar pretendimi ankimor në fjalë.

Andaj, bazuar në rrethanat e konstatuara si me lartë si dhe në mbështetje të nenit 13 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcaktohet se:... 4. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pas pranimit të ankesës, në afatin ligjor, vendos duke miratuar apo ndryshuar vlerësimin e mbikëqyrësit (vlerësuesit), Kolegji ka ndryshuar Formularin e Vlerësimit të Rezultateve në punë për vitin 2021, për ankuesen vetëm në pjesën e periudhës së vlerësimit ashtu që periudha e vlerësimit 01.01.2021 deri 10.11.2021 zëvendësohet më periudhën 30.03.2021 deri me 09.11.2021, ndërsa detyrohet mbikëqyrësi pasues i ankueses që të bëjë vlerësimin e rezultateve të punës për ankuesen për periudhën nga data 10.11.2021 deri me 31.12.2021.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit do të ndërmarr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligji Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 dhe 1.4 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej

tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A. nr. 52/2022

**Rushit KAJTAZI**

*[Signature]*  
Procesmbajtës

**Ardita Haxhnikaj- DEMI**

*[Signature]*  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Zv. Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Sigurisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Këshillin e Sigurisë së Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së,

